

“ENCIKLOPEDI PËR VRESHTARINË DHE VERËTARINË” (Tiranë, janar 2013)  
Prof. Dr. Andrea Shundi

I. ARTIKUJ/TERMA DHE SINONIME NË ARBËRISHT TË PARAQITURA NË “ENCIKLOPEDI”

ArbërishtShqip

Agullaç (sin.) = Rrush i papjekur.

Ajht (sin.) = Amësim

Anason (sin.) = Uzo

Anëzi (sin.) = Anason, bimë.

Anicë (sin.) = Uzo

Aradhë (sin.), (arbr.). = Rresht

“Arb” (art.) = Ekotip vendës hardhie.

Ardhi (sin.) = Hardhi

Ardhizë (sin.) = Hardhi

Argomë (sin.) = Ugar

Armonje (sin.) = Prashitje

Armurele (sin.) = Piketë

Arpagua (art.) = Almise hekuri për voza.

Arpan (art.) = Almise druri për voza.

Aski (sin), (arbr.). = Calik

“Asprun” (art.) = Ekotip vendës hardhie

Asher (sin.) = Cung

Babinpas (sin.) (arbë.) = Kacë

Baçvar (sin.), (arbë.) = Vozëtar

Badil (sin.), (arbë.). = Lopatë

Baltë (sin.), (arbr.). = Llurbë

Bancim (art.)= Lidhje e shermendeve dhe lastarëve.

Bani (art.) = Brez toke rrëth vreshtit që nuk kullotet.

Bastunere (sin.) = Lastar

Biljezë (sin.) = Fidan

Biqer (sin.) = Bardhak

Boc (sin.), (arbë.). = Shishe

Brezë (sin.) = Lesë

Brezim (sin.) = Lesim

Bubuqe (sin.) = Syth

Bucjelë (sin.) = Bucelë

Bukirë (sin.) = Bardhak

Bumbuliqe (sin.) = Rruaza në verë.

Bumbuqe (sin.) = Syth

Buqer (sin.) = Bardhak

Burbukje (sin.) = Burbuqe

Bute (sin.) = But

Butil (sin.) = Hinkë

Butlun (sin.) = Damixhanë

Capul (sin.) = Capë

Capun (sin.) = Shatërkaz  
Careqe (sin.) = Kaçile  
“Cebib” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Ciarlë (sin.) = Kanë  
Cice = Kanë  
Cicë (sin.), (arbr.) = Kanë druri  
Cip (sin.) = Cung  
Cop (sin.) = Lastar  
Cuettu (sin.) = Pekmez  
Çil (sin.) = Syth  
Çip (sin.) = Cung  
Çipë (sin.) = Kurorë  
Çirut (art.) = Rrush pothuaj i pjekur.  
Çupak (sin.) = Cung  
Damjan (sin.), (arbë.) = Damixhanë  
Dultin (sin.), (arbë.) = Deltinë  
“Duraca” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
“Durak” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Dhestër (sin.) = Shullë  
Dhari(sin.) = Hardhi  
Dhrizë (art.) = Hardhi e re.  
Eptar (sin.) = Hektar  
Eri(sin.) = Amësim  
Ëndëz (sin.) = Syth  
Fillestare (sin.) = Lastar  
Fitër (sin.) = Syth  
Fixhollë (art.) = Gropë për mbëltim fidani.  
Fjetë (sin.) = Gjethe  
Flleçk (sin.) = Lëvore  
Ftuzazish (sin.) = Larushk  
Ftuzë (sin.) = Larushk  
Fudhë (sin.), (arbr.). = Lëvore  
Furkunnë (sin.) = Furkë  
Fytim (sin.) = Mbëltim  
Galletë (art.) = Broke druri për verë.  
Garravjel (sin.) = Tinar  
Gërotje (sin.) = Krasitje  
Gërsi (sin.) = Rrënje  
Gostar (sin.) = Syth  
Gogonar (sin.) = Vile  
Grapient (sin.) = Prashitje e thellë.  
Gresht (sin.), (arbë.). = Rrush i papjekur.  
Gurgull (sin.) = Gllënjkë  
Gusht (sin.) = Shërmëri  
Gjërim (sin.) = Krasitje  
Hakë (sin.) = Degë  
“Hardhagjel” (art.) = Ekotip vendës hardhie.

Hekurtë (sin.) = Almise  
“Hora” (art.) = Kultivar vendës hardhie.  
Jëmez (sin.) = Copë  
Kadhe (sin.), (arbr.). = Kade  
Kakon (art.) = Dritarezë në but  
Kakon (sin.) = Shtupë  
Kalenduar (sin.) = Janar  
Kaljavesh (sin.) = Vile  
Kaljaveshëz (sin.) = Vilez  
Kallënduar (sin.) = Janar  
Kallodhje (sin.), (arbr.). = Tëharrje  
Kamanar (sin.), (arbr.). = Vile e dytë  
Kantor (sin.), (arbë.). = Tra me fole, ku vendoset voza.  
Kapazon (art.) = Amforë e madhe  
Kaquall (sin.) = Përpajnjë  
Kartuç (sin.) = Kanë  
Karut (sin.), (arbr.) = Kade  
Karraq (sin.) = Vozë e vogël  
Karraqe (art.) = But i madh  
Kashun (sin.) = Kosh  
Katoq (sin.) = Kantinë  
Katuri (sin.), (arbr.). = Përpajnjë  
Kënatë (sin.) = Kanë  
Kiiz (sin.) = Kizë  
Kizh (sin.) = Kizë  
Kinje (sin.) = Krasitje  
Kokomar (sin.) = Vilez  
Kokoshel (sin.), (arbr.). = Breshër  
Korqë (sin.) = Lëvore  
Krenastar (sin.) = Vile  
Kromastar (sin.) = Vile  
Kryerinë (sin.) = Bucelë  
Kucar (sin.) = Cung  
Kucërë (sin.) = Hardhi  
Kucur (sin.) = Cung  
Kuku (art.) = Enë vere prej 0,5 l.  
Kulonnë (art.) = Degë  
Kumëtatë (sin.) = Enë  
Kupic (sin.) = Tenjë  
Kurkunar (sin.) = Vile  
Kustrosëma (art.) = Bukëz me rrush të terur.  
Kutruc (sin.) = Bisht i viles.  
Landare (sin.) = Vile me kokrra të rralla.  
Lastër (sin.) = Lastar  
Lavrak (art.) = Vile e gjatë.  
Lënt e ‘dhrisë = Verë  
Lostar (sin.) = Lastar

Lino (sin.), (arbr.) = Trokull  
Linua (sin.) = Gaviç  
Lirushë (sin.) = Larushk  
Lisare (sin.) = Pjergullim  
Lisariel (sin.) = Pjergull  
Lumaqe (sin.) = Syth  
Lylëzim (sin.) = Gëlim mushti.  
Llanar (sin.) = Korrik  
Llanxhele (sin.) = Brokë qeramike.  
Llimik (sin.) = Lambik  
Llonar (sin.) = Korrik  
Macokull (art.) = Tufë me shermende.  
Majoll (sin.) = Fidan  
Majollë (sin.) = Kalem  
Majonje (sin.) = Capitje  
Mannaturë (sin.) = Lulëzim  
“Mantonikoz” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
“Marvazezë” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Marvazi (sin.) = Malvazia  
Mastrapë (sin.), (arbr.) = Lagjin  
Mashiaturë (sin.) = Capitje  
Mashkur (sin.) = Brymë  
Mashtrapë (sin.), (arbr.). = Lagjin  
Matukë (sin.), (arbr.).= Shat  
Mavovje (sin.) = Tëharrje  
Mbishkullanxje (sin.) = Raki  
Mboli (sin.) = Shartesë  
Mbroni (sin.) = Vozë  
Mbushë (sin.) = Verë  
Mbut (sin.)= But  
Melth (sin.) = Breshër  
Merë (sin.) = Amësim  
Merikotë (art.) = Musht i trashur.  
Meter (sin.), (arbr.). = Kanë e madhe.  
“Mëndonk” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Mëng (sin.) = Benë  
Mieru (sin.) = Verë  
Mirixje (sin.) = Erëmirim  
Monk (sin.) = Trokull  
Mostopitë (sin.), (arbr.) = Pite mushti.  
Motim (sin.) = Moshim  
“Muhtaro” (art.), (arbr) = Ekotip vendës hardhie.  
Mulëngjez (sin.) = Degëz  
Mullit (sin.) = Verë e athët.  
Mullogë (sin.) = Verë e prishur.  
Munnaturë (sin.) = Lulëzim  
Murrinje (sin.) = Krasitje

Muskarelë (sin.) = Mizë e uthullës.  
Must (sin.) = Musht  
Must zier (sin.) = Musht i zier.  
Mushtë (sin.) = Musht  
Mushtëshim (sin.) = Shtypje/Dërrmim rrushi.  
Mushtor (art.) = Verë që ende ka musht.  
Mushtëshim (sin.) = Shtypje/dërrmim rrushi.  
Mushtullor (sin.) = Mushtak, rrush për pekmez.  
Nakë (sin.) = Degë  
Ncëtim (sin.) = Shartim  
Ncufanommje (sin.) = Mbathje dheu.  
Ndinë (sin.) = Degë  
Ndipull (sin.) = Shtupë  
Nëkeqe (sin.) = Hiri  
Ngalërim (sin.) = Kacavarje  
Ngallim (sin.) = Ngjërim  
Nganatik (sin.) = Rrush i papjekur.  
Ngridhje (sin.) = Tharmim  
Ngjepsje (sin.) = Ngjërim  
Ngjironje (sin.) = Ngjërim  
Ngjot (sin.) = Fundërr  
Njërim (sin.) = Ngjërim  
Nocull (sin.) = Bërsi  
‘Ntruzza (sin.) = Trokitje bardhakësh, Gëzuar!  
Nturtonje (sin.) = Kacavarje  
Nuzzulu (sin.) = Farë  
Nxertë (sin.) = Shartesë  
Nxëtë (sin.) = Shartesë  
Nxëtim (sin.) = Shartim  
Nxitarenje (sin.) = Shartim  
Nxitë (sin.) = Shartesë  
Pagiare (art.) = Strehim prej gurësh në vresht.  
Palemintaru (sin.) = Verëtar  
Pamnë (sin.) = Gjethe  
Pargulé (sin.) = Pjergull  
Pastaniel (sin.) = Vresht i ri  
“Passularë” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Pargulé (sin.) = Pjergull  
Pénjith (sin.) = Dredhcë  
Pepëti (sin.) = Gllënjkë  
Petalore (sin.) = Përpajnjë  
Pëcëkalorë (sin.) = Gérshëre  
Përbashënë (sin.) = Përpajnjë  
Përthënie (sin.) = Fjalë e urtë  
Pëtalorë (sin.) = Përpajnjë  
Picikalorë (sin.) = Gérshëre  
Pir (sin.) = Sop i butit

Pirocull (sin.) = Shtupë e butit.  
Pirpajn (sin.) = Përpajnë  
Pishnesë (sin.) = Dolli  
Pishotull (sin.) = Sop i butit.  
Pjegull (sin.), (arbë.). = Pjergull  
Polluvin (sin.) = Fidanishte  
Porsilitje (sin.) = Diellzim  
Porsili (sin.) = Shullë  
“Primitiq” (sin.) = “Primitivo”  
Puluvinjë (sin.) = Fidanishte  
Pupiqe (sin.) = Vile e vogël, Cibërr.  
Pupiqë (sin.) = Vile e vonë.  
Purgulea (sin.) = Pjergull  
Putosje (sin.) = Krasitje  
Qafoketë (art.) = Kade  
Qandim (sin.) = Mbëltim  
Qatull (sin.) = Shtëngë  
Qukonje (sin.) = Lidhje në gjelbërim, e parë e lastarëve.  
Rahan (sin.) = Verë e zier.  
Ranoi (sin.) = Raki  
‘Rdhi (sin.) = Hardhi  
Reshik (sin.) = Calik për verë.  
Retiu (sin.) = Shermend  
Rësolli (sin.) = Raki  
“Risait” (art.), (arbr.). = Ekotip vendës hardhie.  
Runcellë (sin.) = Kizë  
Runçëdun (sin.) = Kizë  
Runcigjun (sin.) = Kizë  
Rrungonje (sin.) = Krasitje  
“Ruxh”(art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Rrasollë (art.) = Almise, shpatull për almiset e punimit të tokës.  
Rraspë (sin.) = Frenjë  
Rrçop (sin.) = Vile e vogël.  
Rrepan (sin.) = Lastar  
Rreshik (sin.) = Calik për verë.  
Rrethe (sin.) = Shermend  
Rreshik (sin.) = Calik  
Rrethe (sin.) = Shermend  
Rrëçopë (sin.) = Vilez  
Rrëfatë (sin.) = Frenjë  
Rrëferë (sin.) = Frenjë  
Rrëjullë (art.) = Derëz e butit.  
Rrëjullim (art.) = Mbyllje e rrëjullës.  
Rrëmb (sin.) = Fidan  
Rrëmb (sin.) = Degë  
Rrëmb (sin.) = Vile  
Rrëmb i ri (sin.) = Degëz

Rrëpulë (sin.) = Lastar  
Rrëshik (sin.) = Calik  
Rrfiksje (sin.) = Terje  
Rjull (sin.) = Derëz voze.  
Rrong (sin.) = Kizë  
Rroomb (sin.) = Vile  
Rrshiq (sin.) = Calik  
Rruezzulu (sin.) = Branë  
Rrufan (sin.) = Frenjë  
Rrufar (sin.) = Frenjë  
Rrufarë (sin.), (arbr.). = Frenjë  
Rrufarë (sin.), (arbr.). = Vile  
Rrugje (sin.) = Kanë qeramike.  
Rrugjik (art.) = Kanë e vogël.  
Rrungonje (sin.) = Krasitje  
Rrushezit (sin.) = Vend me vresht.  
Rrush i rrëfiksur (sin.) = Rrush i terur.  
Rrush nganatik (sin.) = Rrush i papjekur.  
Rrusht (sin.) = Rrush  
Rrushtë i strëngur (sin.) = Bërsi  
Sallmende (sin.) = Shermend  
Sallmjendim (art.) = Shermende të lëshuar teposhtë.  
Sallëmendim (art.) = Mbledhje nga toka e shermendeve të krasitura.  
Sallëmjendë (art.) = Shermend i tharë.  
Saramendë (sin.) = Shermend  
Sarkjoddë (sin.) = Capë  
Srrorje (art.) = Nxjerrje nga ena e mushtit, verës.  
Skancim (sin.) = Zvjerdhje  
Skavadomë (sin.) = Zvjerdhje  
Skollatur (sin.) = Fundërri vere.  
Skorcë (sin.) = Lëvore  
Skurrirje (sin.) = Rrëzim i luleve.  
Spalë (sin.) = Lastar  
Spiranost (sin.) = Vrug  
Stefanj (sin.), (arbr.). = Rrathë voze.  
Shabllakuke (sin.) = Verë e holluar me ujë.  
Shabllakuke (sin.) = Verë rishtare.  
Shamarr (sin.) = Shat  
Sharap (sin.) = Verë e parë, verë rishtare.  
Sharapë (sin.) = Verë e prishur.  
Shemmë (sin.) = Lastar  
Shënar (sin.) = Janar  
Shën Mërtir (sin.) = Nëntor  
Shën Mitër (sin.) = Tetor  
Shën Ndré (sin.) = Dhjetor  
Shërmëri (sin.) = Gusht  
Ship (sin.) = Qilizmë

Shkëmesje (sin.) = Krasitje  
Shkok (sin.) = Vile  
Shpërun (sin.) = Çep  
Shpërunik (sin.) = Çepim  
Shqezë (sin.) = Lesë  
Shtagë (sin.) = Shtëngë  
Shtierje (sin.) = Bulëzim  
Shtrydhore (sin.) = Trokull  
Shtumpëshim (sin.) = Shtypje rrushi.  
Shungasje (sin.) = Larosje  
Timbanj (art.) = Fund dyshemeje i vozës.  
Tinelë (sin.) = Sheke  
Tinë (sin.) = Gaviç  
Tork (sin.) = Trokull  
Traggië (sin.) = Branë  
Trajllim (sin.), (arbë.). = Trokullim  
Trivil (sin.) = But  
Trupjel (sin.) = Cung  
Theristi (sin.) = Qershorr  
Thumbth (sin.) = Syth  
Udhri (sin.) = Hardhi  
Uerciu (sin.) = Calik për verë.  
Upri (sin.) = Almise  
Ursulu (sin.) = Faqore  
Ush (sin.) = Rrush i papjekur.  
Ushull (sin.), (arbë.). = Calik  
Utë (sin.) = Vozë  
Utar (sin.) = Vozëtar  
Uthëti (sin.) = Tharti  
Valle-valle (sin.) = Gërshetim  
Vangë (art.) = Bel i ngushtë.  
Vanjunë (sin.) = Gjethëz  
Varllar (sin.) = Vozëtar  
Varrillar (art.) = Tra ku pushon voza.  
Varrij (sin.) = Vozë  
Varriq (sin.) = Bucelë  
Varriqe (sin.) = Vozë e vogël.  
Varrillar (art.) = Tra me fole, ku vendoset voza.  
Varrillar (sin.) = Vozëtar  
Vashile (sin.) = Barelë  
Vedrë (sin.) = Vedër  
Vengë (sin.) = Bel i ngushtë.  
Verë uthulle (sin) = Verë uthullaçë.  
Vermenë (sin.) = Degëz  
Vesh (sin.) = Vile e vogël.  
Veshyth (sin.) = Vilez, vile e vogël.  
Vëneshtinjm (sin.), (arbë.). = Vreshtim

Vidhel (sin.) = Hardhi  
Vidhël (sin.) = Hardhi  
Vilez (sin.) = Hardhi, pjergull.  
Vinasë (sin.) = Bërsi  
Vinocat (sin.) = Bërsi  
Vivil (sin.) = Krimb, parazit.  
Vjela (art.) = Rrush i sapovjelë.  
Vjesht (sin.) = Shtator  
Villostar (sin.) = Lastar  
Vishkull (sin.) = Thithak  
Vishkull (sin.) = Lastar uji  
Vitull (sin.) = Lastar  
Vllastër (sin.) = Lastar  
Vllastisje (sin.) = Shartim  
Vozgë (sin.) = Vozë  
Vozgëtar (sin.) = Vozëtar  
Vreshtëtar (sin.) = Vreshtar  
Vucar (sin.) = Vozëtar  
Vucë (sin.) = Vozë  
Xareqe (sin.) = Kaçile  
Xhaknisnje (sin.) = Zbrujtje  
Xhixhë vere (sin.) = Plloskë druri.  
“Zagarezë” (art.) = Ekotip vendës hardhie.  
Zahire (art.)= Tëmotje  
Zbin (sin.) = Lastar  
Zburraturë (art.) = Verë me rrjedhje, pa shtrydhje të rruflave.  
Zuekku (sin.) = Kazmë

## II. FJALË TË URTA, DOKE, RITE, KËNGË NË ARBËRISHT, TË PARAQITURA NË “ENCIKLOPEDI”

“Aiqipariz dhe ajo hardhi e bardhë, që i qarkohet përjetë”.  
“Bahe e lakre, edhe vera katër surde(bathë e perime, pihen edhe me verë të lirë, që kushton katër qindarka)”.  
“Bëj nur (zbukuroj)vreshtën, valle-valle” (këngë që hidhet valle).  
“Bëj verë në trivil”.  
“Bëju uthull se miza kërruset (tërhiqet)”.  
“Biret me nj’biqerver”.  
“Breshri ndë vresht, i zoti me at kaloqe(bastun)” (dëm dëmit).  
“Buka e shërbyer dhe vera e matur”.  
“Buka (gruri)ndë maj, vera (rrushi)ndë gusht.”  
“Bukë e verë dhe më gjë (gjerë)”.  
“Burrat pinveran nga bucjel ma kaniti(mekanellë)”.  
“Buta e vogla benveran e mir”.  
“Buti po çet” (qet, pikon, rrjedh) (arbë.).  
“Butja është plot me verë”.

“Butja jep verën çë ka”.

“Butja ime ng(nuk) ka më verë, më s’njeri(asnjëri) më sheh në faqe”.

“Butja më mirë të pikojë sesa të rrjedhë”.

“Çfarë rrallohet, ndrashet”.

“Daljëm nga kisha e ndajëm koqe (drithëizier), verë, bukë” (arbr.).

“Do të qell (shtrydh)rrushtë në lino” (trokull).

“Dua më veren se ujet”.

“Duhim mirë (duajeninjëritjetrin), si buk-a/ën dhe ver-a/ën”.

“Dha shatin deri te këmbët e tij (hardhitë i prashiti deri në rrëzë)”.

“Eshtrembër si dhria(pjergulla)”. Nuse me trup jo të bukur.

“Edhe të vdekurit shkojnë për të pirë një qelqe me verë”.

“Emëvengë e të jap lëng”.

“Erth Shën Mitri, erth dimri”.

“Fundërrima e verës ishtmjalët i dimrit”.

“Fyto(mbëlto) edhe në prill”.

“Gaidhuri a bian, e Gaidhuri a ha” (“Gomari e bart rrushin dhe gomari e ha”. Vonesat në vjelje dhe bartje, rrushin e dëmtojnë).

“Gojën e ka në mest të barkut” (Gjëegjëzë: voza).

“Hardhia është mbretëresha e pemëve”.

“Hiku dimri me marsin”.

“Hiku vapa me gushtin”.

“I émbëlth si shiu i prillit”.

“I glat(gjatë) si nata e Shën Ndreut”.

“Janar i thatë, bujk i begatë”.

“Ju mburoftë vera, si shura(rëra)n’det”.

“Ka buzën ndëmestgradhes” (“Ka gojën në mes të shpinës”. Gjëegjëzë: voza).

“Kajkvashile(kaq barela) porMarvazi!”.

“Kalikush(kaluar) nuk han rrush”.

“Kjo verë bëndhika(e bekuar)ësht si uji ka kroi pika pika(ujëipërkryer)”.

“Kjo verë vjen nga rrushi, rrofsh shumë vjet papasBellushi”.

“Kokosheli(breshri)katastrepesi(shkatërrroi)vreshtënë edhe u tha” (arbr.).

“Kulaç me brumë, mbrujtur me vezë dhe merikotë”.

“Kur buti isht plot, gjithë thonë: Mirëdita, zot”.

“Kur dhelpa nga’rrën te rrushi, that se isht agullaç”.

“Kur ha mish dhe pi verë, dimëri nuk ka çfarë të bën”.

“Kur në tries(tryezë)isht edhe vera, gjithashtu ajo buzëqesh”.

“Kur u bë uthull, nëng(nuk) i vlen të i ndrosh butan (vozën)”.

“Kush m'u dha verën mua, Krishti ja mburoftë si krua!”.

“Kush pi verë e ha bukë, djathë e bjuremë, bën të bukrë pranverë”.

“Kush vjel e kush bën butje”.

“Lëng rrushi i shtrydhur në shtrydhore”.

“Lëngu erdhisë(vera)isht sisë e pleqërisë”.

“Llëngu i drisëisht gjaku i pleqërisë”.

“Mas Pashkës piet vena e kuçe” (arbë.).

“Mbas tri mushkurrat(brymave), shi o borë ditë e natë”.

“Mbronia(voza) rri mbënj’vend e bukuroshja vete e vjen” (Gjëegjëzë: kana).

“Mbum(mban) sit (sytë) te rogjeja”.

“Mbusha më pëlqen”.

“M’ë bën vreshtat vivila(krimba, parazitë), sa s’më lëshoi fare gjë (nukprodhoi)”.

“Me lëngt e dhrisë i uronjë shoqërisë”.

“Me mir te pish vert’ngroht, se ujtfrishku(freskët, ftohtë)”.

“Me një lugëz uthull , rrus(largon) edhe Mizat”.

“Me një vresht e me një palë (pajë/prikë) marton një bil(bijë)”.

“Me një vuc uthull i knjen gjithë Mizat”.

“Më beló, të jap Musht”.

“Më beló, të jap rrush”

“Më i ëmbël se mjalti dhe merikota”.

“Më mir të pish verë t’ngroht, se ujtfrishku(tëfreskët)”.

“Më shkit një veshyth(vilez) nga veshi i rrushit, që ta ngjeronj”.

“Miku por edhe i panjohuri, gostitet së paku me një qelqe me verë shtëpie”.

“Mikun a bën me një pikë verë; ta mbash nga’rren ma një but”.

“Mirënjojje dhe respekt, nëse voza isht plot me verë”.

“Mo dua venën te zi se te bardh” (arbë.).

“Mokandam’o vena e vjetshme” (arbë.).

“Mos vil aty ku nuk ke mbëltuar” (arbë.).

“Mora nj’vesh rrush”.

“Mori ballite të kazanit”.

“Mushti po lylëzon”.

“Mushtin e mbajmë në ushunj(calik)” (arbë.).

“Ndë dimër rrëmohen vreshtat”.

“Ndë një vresht, ndë një kucërë, kendonë një zog i bukure”.

“Ndë Shën Martin çdo lloj mushti kthehet në verë”.

“Ndëvjesht piqen rrushtë; me lëngt e dhrisë, uronjë shoqërisë”.

“Ndërsa laheshe nën pergule(djaliithotëtëfejuarës)” (arbr.).

“Nëvëneshtkamtremijëcungaardhi” (arbë.).

“Nëk (nuk) esellen(sollën) cicen (kanën) neverë”.

“Në ke mundësi, krasit dhe prashit qysh të kremlten e Gjithëshejtorëve” (1 nëntor), (arbr.).

“Në nuk ke shtëpi as vresht, nuk të sheh as një plesht”.

“Nëse buten e lan, bën dhe pi verë të mirë”.

“Nga e enjta e shenjtë (triditëparaPashkës), deri ditën e Shëmbëllimit (ngjitjesnëqilli të Krishtit, 40ditëmbasPashkës), në vresht nuk punohet; përndryshe breshëri i dëmton hardhitë”.

“Ngjyeje (jonjome) bukën në verë sepse të shijon më shumë” (bukamerr ngjyrën dhe shijen e verës).

“Ngjyrë kuqe, si e verës”.

“Nxiri ato lule verës”.

“Nji pik ven e nji grim buk, mua m’omjat(mjafton)” (arbë.).

“Një cicë(kanëdruri) me verë” (arbr.).

“Një pikë verë e sëmuri shërone”.

“Një pikë verë, një tul buke, një hudhë: shkohet e vihet”.

“Një përbashenë(përpajnë) bën një dhri”.

“Një prashitje, sa gjysmë ujtje”.

“O të vemi të rrëmojmë vreshtënë me matuke(shat) edhe ‘o të mbljedhmëbotënë(dheun) të bëjmë gumulle(mbathje)” (arbr.).

“O Zot, shtoje verën, si ranishtja në bregdet”.

“Oh për një kulaç të ngrohtë dhe një shishe me verën e shtëpisë!”

“Oj e bukura si vera!”

“Oj e bukura si vera, mos le qiqin(kyçin) te dera!”.

“Pe mushti del vena, pe fumiut(fëmijës) krijohet njeriu i pjekuruar” (arbë.).

“Pi më (mëshumë) verë, të merr trutë”.

“Plaku pa verë ësht si pishku pa uj”.

“Prilli bën lule dhe maji ka nderën”.

“Pa ardhur gushti nuk piqet rrushi”.

“Pafsh hije (nder), si buka e vera!”. Urime nuses.

“Për vjelje të majme duhet që Pashka të jetë me lagështi dhe Krishtlindja me thatësirë”.

“Përpara a zu peronospora (vrugu), e pas i erdhi edhe breshri” (Kur gjithë të këqijat mblidhen tek njëri).

“Pi të ëmblën dhe mandej jep të kthjelltën” (Gjëegjëzë: voza).

“Porsi vera qelqeve” (valle e kënduar).

“Priti ato spalëdhrisë”.

“Pulike(makarona) me vere e bardhe”.

“Pullart (mëzat) zëhen, e vuct(vozat)trucaren(dëmtohen)”.

“Pullejt (mëzat) zëhen, evarrejt(vozat) ven për ndëmest”.

“Putohen(krasiten) vreshtat mos ‘dhritë të sallmenden(shermendettëlëshohenteposhtë)”.

“Qindroi(mbeti) si erdhia kur i marren rrushtë” (Si nëna pa fëmijë.).

“Rdhia me shumkapriolla(shermende), bën pak rrush”.

“Rrethe(shermende) të shkurtër, vjelje e gjatë”.

“Rrëmon vreshtin dhe ruan argomën(ugarin)”.

“Rrëshiqi bëhet me lkuren e kaciqit(kecit)”.

“Rrofshi sa buka dhe sa vera” (urim për çiftin më dasmë).

“Rroftgluha jon, sa buka dhe vera!”.

“Rrush ftuzazish”.

“Rrush i bardhë, verë e kuqe/ Sa e bukurëm'u duke” (arbr.).

“Rrushtë pa arrirë, bëj gati kofinë”.

“Sado verë të pi, një rrëmb rrushi dua ta haj”.

“Semë(sillmë) një rrufarë(vile)” (arbr.).

“Sfrrar(nxjerrngaena) mushtin”.

“Si ishtdhria del rrushi”.

“Si ishtdhria duhet nruri(huri)”.

“Si ishterdhia vë hun (hurin), si isht shati vë mrun(bishtin, dorezën)”. Gjérat duhet të përshtaten.

“Siishtkarraqja(butimadh), vjen vera”.

“Si rrëferët, pa më kokrra rrushi”.

“Siparitvinjen pe gjutetit(qytetit) me ble ven pe nesh” (arbë.).

“Shërbe bukën dhe mat verën”.

“Shi se nëng të e preva fara u vreshtan” (“Shiko se vreshtin nuk ta preva unë”. Lidhet me Kanunin, kur fajtori ndëshkohej duke i prerë vreshtin).

“Shpi sa rri, verë sa pi, dhera sa sheh me si (sy)”.

“Shpi sa rri, vresht sa pi”.

“Te i pari shi i t'gushtit, njihet i begati dhe i vapku(varfëri)”.

“Te na vera isht femër, kurse letirët(italianët) e kanë mashkull (vino)”.

"Te vreshta rrmojmë, 'dhritë i skalismë(prashtim), vemi i trigjismë(shermendetishtrijmënëtel) dhe i tjafismë(lidhimlastarët); nani(tashti) vemi e ksefillismë(rrallojmëgjethet) dhe pastaj rrush ta vëmë te buta, ta pimë te dimri" (arb.).

"Tek ajo vresht u beftit ver, sa pi zoti te kallçi".

"Të shërbyerit që bën nder, ishtqelqthi me ver".

"T'mbanj (nderoj) si një qelqe në tries(tryezë)".

"Trembësia i ruan vreshtat më shumë se i zoti".

"Tri ditë mbas Pashkëve nuk punohet në vresht, përndryshe bie breshër".

"Triesa(tryesa) pa ver s'ka hije".

"U vajta ka vreshta e kur pa ata rrush, ju përgëzova".

"Uja vete prapa de spënali e vera mbre bark" ("Uji mbas shpine dhe vera në lukth").

"Vemëvreshten, valle-valle" ("Shermendet i gërshtetojmë në tel").

"Vemi të shkelimërrushtë" (arbr.).

"Vena t'o çart prishur përse nuk i ke sumpurat(larë) butet" (arbë.).

"Vera e erdhisështklumshti i pleqësisë".

"Vera e jonë (shtëpiake) më pëlqen, sepse e di çfarë pi".

"Vera isht si gruaja dhe makina, që secili pëlqen të veten".

"Vera ime ishtkllënjintribull".

"Vera jote ishtshabllakuke(meujë)".

"Vera po rrjedh nga rrëjulla".

"Vera t'mir bëhet uthull".

"Veran ta kënata (kana) e fiqët ta shporta, mbushan shpin".

"Verën pije nga rrogja(kana)".

"Vjen marsi, mirësevjen".

"Voza me verë nuk ka dhëmbë por gojë" (firas).

"Vozat bosh qeshin, plot qajnë".

"Vresht s'kej, fare s'gje(vresht nuk kishte, hiç gjente)" (arbr.).

"Vreshtameshumepamna (gjethe), benpakrrush".

"Vreshta shkurriti (rrëzoi lulet)".

"Vreshti dhe ullishtja mjaftojnë që familja të jetojë mirë".

"Vreshti vërtet nuk e pasuron familjen, por ama e mban mirë".

*Dokefejese:* "Te pragu i shtëpisë djali vendoste një cung hardhie për të treguar gjëzimin e fejesës. Cungu mbahej për disa ditë, në mënyrë që tërë fshati të njoftohej" (arbr.). Ngjashëm me të: "Një natë para se të shkohet tek shtëpia e vajzës për mblesëri, përpara derës i vihet një cung hardhie. Nëse në mëngjes cungun e fusin në shtëpi, atëherë përgjigja është për mirëseardhje" (arb.).

*Rrëfim* vreshtari dhe verëtarë: "Te vreshti rrëmojmë, vemë e ksefilismë, vemë edhe i tjafismë; nani (tani) do vemi t'i trigjisimërdhitë, të skalimërrushtë, t'i vëmë te buta, ta pimë te dimri" (arbr.).

*Rit martese:* "Dhëndëri dhe nusja pinë tri herë me radhë verë të bekuar, për të dëshmuar se martesa përbën një lidhje që shkëputet veç në vdekje".

Grurë i apo zier haet duke u shoqëruar me pirje vere të apo vluar; ky çift ushqimesh dërgohet edhe tek fqinjët (rit që sidomos kryhet të kremten e Shën Luçies).

*Mit:* Arbëreshët dëshmojnë se kur në shekujt XIV-XV u larguan nga mëmëdheu, ushqimet që morën me vete ishin bukë dhe verë, si ushqim themelor dhe vera bartej e ruhej në caliqe.

"Çifti i të dashuruarve arratiset nga fshati por vritet nga prindërit; tek varri i tyre mbin një

qipariz që përfaqëson dashnorin dhe një hardhi e bardhë që përfaqëson dashnoren e cila përjetësisht qarkohet tek qiparizi”.

“Zanat shkojnë tek butet dhe përmes kakonit (derëzës së butit), verën e pinë duke e vlerësuar. Nëse është e mirë nuk bëjnë asnjë të keqe, por nëse vera është e prishur, atëherë e turbullojnë. Kur dikush nuk ka but me verë, zanat nuk shkojnë tek ai”.

*Urime:* “Qofsh me nder moj nuse, si buka mbi tries dhe si vera në qelqe”.

*Zakone:* Me t'u ngulitur në Itali, menjëherë arbëreshët mbëltuan hardhi (dëshmohet qysh më 1543). Çdofamiljearbëresheprodhonverënështëpi (çdo fshat në Shqipëri selit vreshta ose së paku ereke a pjergulla). Hapja e butit me verë, kremtohet familjarisht më 8 dhjetor, ditën e Zonjës së papërlyer dhe quhet “Shën Mëria e butes”. Mbrëmja e verës kremtohet fshatçë me 10 gusht, duke u emërtuar “Qelqe (bardhakë) nën yje”. Grurë i zier ashtu sikurse buka, përsheshet në verë.

*Emërtime:* “Llaka (lugina) e Sarmentit” (ndodhet në Pullin Llukan të Kozencës).

*Këngë:*

“Verë që del nga hardhia / Me urdhër nga Perëndia / Ta pirë njerëzia / Të madhitohet dashuria”.

“Kjo verë vjen nga rrushi / Një urim i bën zotit Belushi / Kjo verë vjen nga dhria / Një urim ghithë lla kompania (shoqëria)”.

“Mbaj mend kur vejem ka vreshta / me di panare (shporta) të holla / Faqet t'shelqenjen si molla / Si molla më i ke ti. / Mbaj mend kur vejem ka vreshta / Me di panare të trasha / Faqet t'shelqenjen si llastra (qelqi) / Si llastra m'i ke ti”.

“Katundi, Vreshti, Vera.” (Këngë nga Gregorio Talo, San Marcano di San Xhuzeppa.)

123

Ngadita ka te këndoni	Nunni (xhaxha) Seppi	Kur e shpie mushku jashte
Ta pire nje qelqe vere	Itti (ishte) i likë (sëmurë)	Nengë (nuk do) fare te shurbej
Qe ishte katundi jonni	E uguri (filloi) xitur ta pire	Pine vere e hane kashte
Katundi ku kime lere.	Habbi (tha): vera mua më ndikë	E poshtë lize (lisit) do vej flej.
Keshtu vete (vetëm) jese mire.		

4

5

6

Me habbinjëheretatta	Kure shume me vjen etja	Qe duanni te rronnissumme
Se gjithë inri mjeshtre	Pi nje vere pase-pase (dalëngadalë)	Ndjenje njetre here
Te mblomi (mushni) vere kënata (kanë)	Jese mire me shendetje	Kure hanni e mirrenigjume
E jo te punomovreshte.	E ndihme si mbra (pas) parase (parajsës).	Enderrini te pini vere.

P.S. 1. Një popull sikurse arbëreshët, gjaku i shprishur i shqiptarëve qysh pesë shekuj më parë, që shprehen “Buk e ver e më gjë (gjerë)”, ku vera prodhohet në çdo shtëpi, që mikun së paku e gostitin me një qelqe me verë ka e jona (e shtëpisë), dëshmon traditë e kulturë pune dhe jetese duke i përkushtuar edhe vreshtarisë-verëtarisë.

2. Në librin “Enciklopedi për Vreshtarinë dhe Verëtarinë” (Tiranë, janar 2013) me autor Prof. Dr. Andrea Shundi, në 870 faqe me 3200 artikuj që shoqërohen me 500 foto e skica me ngjyra, paraqiten edhe 850 fjalë të urta ku spikatin 380 terma e sinonime dhe 210 fjalë të urta arbëreshe. Sa mirë që në të njëjtin libër gjallojnë së bashku thesare të shqipes amë dhe të arbërishtes. Për më tepër, paraqitet veprimitaria e disa kantinave arbëreshe. Çdo term është përkthyer në anglisht dhe në italisht.

3. Kjo "Enciklopedi" ka natyrë teknike-profesionale në shërbim të mbarë botës shqiptare, kështu që ana gjuhësore e mirëfilltë nuk del aq në pah. Një pjesë e fjalëve arbëreshe shkruhen me shqipen standarde, nuk shënohen komunat arbëreshe nga është prejardhja e termave dhe e fjalëve të urta, nuk janë vënë theksat në fjalët arbërisht. Shumica dërrmuese e termave-sinonimeve-fjalëve të urta janë të arbëreshëve në Itali prandaj përkrah tyre vihet shkurtesa (arb.), për arbërorët në Greqi është shkurtesa (arb.) dhe për arbnorët në Dalmaci (arbë.).

4. A mund ta pasuroni këtë mbushullim termash-sinonimesh-fjalësh të urta? Autori ju mirëpret edhe përmes e-mailit [andreashundi@hotmail.com](mailto:andreashundi@hotmail.com)